

VENDIM
Nr.804, datë 6.10.2010

**PËR DHËNIE FONDI SHITESË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR
FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE, NË
KOMUNËN TREBINJË, QARKU KORÇË, MË 24 TETOR 2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, në komunën Trebinjë, qarku Korçë, më 24 tetor 2010, t’i jepet një fond shtesë prej 1 542 000 (një milion e pesëqind e dyzet e dy mijë) lekësh, të ndarë përkatësisht:
 - 542 000 (pesëqind e dyzet e dy mijë) lekë për paga e sigurime;
 - 1 000 000 (një milion) lekë për materiale e shërbime.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha